**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**
**DEGA E DOGANËS SHKODËR**

**Nr. 275/5 Prot.** **Shkodër, më 14/04/2022**

**LËNDA:** Kërkesë për shpallje publike

7436
19 4 22

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**
**DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT**
**SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT**

**DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE**

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", *4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..."* kërkojmë shpalljen publike për;

- **Vendimin Nr. 21 datë 25.03.2022** (nr.275/2prot., datë 25.03.2022) shtetasin **"Arjana Preng Shurbi" me numër përsonal H75715058M,** me adresë: Rr. "Abaz Ermenji", Pall.Rafaelo 2002; Nd. ap.2; H. shk.2; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë.
- Për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

**K R Y E T A R**

**Aida DIZDARI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE DEGA DOGANORE SHKODËR MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**
DEGA E DOGANËS SHKODËR

**Nr.**275/2 **Prot.** **Shkodër, më** 25.03.**2022**

# V E N D I M
## Nr. 21, datë 25.03.2022

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, mori në shqyrtim, shkresën nr. 8030/65 prot., datë 25.01.2022, të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Lënda: Urdhër "Për zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve që dalin në raportin përfundimtar të auditimit, ushtruar nga KLSH" (protokolluar me tonën me nr.186 prot., datë 31.01.2022), Konkluzionet e grupit të punës mbi raportin e Auditit të KLSH-së protokolluar me nr.186/2 prot., datë 07.03.2022 dhe procesverbal nr.275 prot., datë 10.02.2022 të mbajtur nga grupi i punës sipas Urdhërit të Brendshëm nr.04, datë 04.02.2022 të Degës së Doganës Shkodër i ngritur për shqyrtimin e materialit të dërguar nga Audituesit e KLSH-së, lidhur me konstatimet e bëra për shtetasen **"Arjana Preng Shurbi" e datëlindjes 15.07.1977, me numër personal identifikimi H75715058M, me adresë: Rr. "Abaz Ermenji", Pall.Rafaelo 2002; Nd. ap.2; H. shk.2; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë.**

Pasi u shqyrtua dokumentacioni i mësipërm rezulton se:

"Arjana Shurbi" me numër personal identifikimi H75715058M, me deklaratën doganore R 3697, datë 21.02.2020 ka importuar dhe deklaruar për zhdoganim, artikullin *"Rimorkio e përdorur JUBILAR, 550 VARIO/VP 1983"*.

Duke u ndodhur në kushtet e plotësimit të kërkesave të nenit 49, 70.2/a, 70.3 dhe 74.21b të Kodit Doganor të RSH-së, si dhe kërkesave të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të MFE "Për vlerësimin e mallrave doganore", artikulli "Rimorkio e përdorur JUBILAR, 550 VARIO/VP 1983", duhej rivlerësuar me 0.7 €/kg në kushtet e lëvrimit FOB.

Për këtë arsye, është bërë rillogaritja e detyrimeve për deklaratën doganore R 3697, datë 21.02.2020, në të cilën individi "Arjana Shurbi" me numër personal identifikimi H75715058M duhet të paguajë shumën 16,688 lekë.

Me anë të shkresës nr. 275/1 prot., datë 10.02.2022 Dega Doganore ka bërë njoftimin e procesverbalit të konstatimeve të audituesve të KLSH-së, hartuar nga grupi i punës pranë DDSH, me anë të së cilës individi "Arjana Shurbi" me numër personal identifikimi H75715058M nuk ka marrë njoftim, pasi zarfi është kthyer me shënimin "larguar". Si rrjedhim, agjencia doganore "Log

In Albania" përfaqësuar nga agjenti Ermal Rrustemaj ka marrë njoftim për procesverbalin e sipërcituar me datë 18.02.2022 dhe nuk ka paraqitur observacion.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në analizim dhe shqyrtim të dokumentacionit të mësipërm, pikën 3, të nenin 70 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, VKM –në Nr. 651, datë 10.11.2017 "Për Dispozitat Zbatuese të ligjit nr. 102.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Pikën 4.5 dhe 4.6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, date 23.1.2018 "Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganor" dhe Udhëzimin nr. 05, datë 26.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave "Mbi Procedurat Standarte të Funksionimit të Sektorit të Vlerësimit Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ".

**V E N D O S I:**

1. Për deklaratën doganore **R 3697, datë 21.02.2020,** të deklaruar nga individi "Arjana Shurbi" me numër personal identifikimi H75715058M, të zbatohet vlerësimi doganor bazuar në pikën 3, të nenin 70 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

2. Detyrimi doganor shtesë që duhet paguar është **16,688 (gjashtëmbëdhjetëmijëegjashtëqindetetëdhjetëetetë) lekë.**

3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Financës për kontabilizim.

4. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore për pasqyrimin e këtij vendimi në sistem dhe amendimin e deklaratës doganore.

5. Bazuar në nenin 281 dhe 282 e Kodit Doganor, kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

**K R Y E T A R**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE
SHKODËR

**AIDA DIZDARI**

*Punoi: A. Dibra*